

**V E N D I M**

**“PER REGJISTRIMIN E SHOQERISE SI PERSON JURIDIK”**

Sot, me date 19/7/02 ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane, une Gjyqtari  
A. K... i kesaj Gjykate pasi u njoha me materialin e paraqitur nga Z. DENIS  
HOXHA per te regjistruar shoqerine si person juridik :

**KONSTATOVA**

Se, Denis HOXHA me cilesine administratorit ka paraqitur kerkesen e tij per te regjistruar shoqerine si person juridik te themeluar prej tij dhe ortakeve te tjere Z. Dritan CELA dhe Z. Alban HASA, te emertuar “**ARK IT**” Sh.p.k. ne kryerjen e aktivitetit per:  
Projektim, mbajtje, implementim, administrim dhe konsulence te sistemeve dhe te softwareve, te bazes se dhenave, te telekomunikacionit, transmetimit te bazave te dhenave dhe interkonektivitetit ne teresi;  
Perfaqesim dhe ndermjetesim ne trasanksione tregtare dhe ne ate te sherbimit ne favor te kompanive apo firmave te tjera qe operojne ne fusha te implementimit te softeve te ndryshem ne vecanti dhe ne fusha te ndryshme ne pergjithesi;  
Montim dhe riparim pajisjesh elektronike dhe informatike;  
Projektimi dhe implementim te sistemeve elektronike dhe telekomunikacionit si dhe software-ve perkatese;  
Ndjekje dhe kontroll i realizimit te projekteve;  
Konsulence teknike, ekonomike e juridike per specifikime teknike te rretave dhe sistemeve te shkembimit te informacionit, ruajtjes se tij si dhe per gara dhe kontraktme;  
Importim dhe instalim sistemesh dhe pajisjesh elektronike dhe te komunikimit.

Me seli ne Tirane, Rr. “Ali Pashe Gucia” Nr. 33, me nje aktivitet me afat te papercaktuar, me kapital fillestar 100 000 (njqind mije) leke. Kerkesa e tij eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE**

Ne baze te Ligjit 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare” dhe te Ligjit 7667, date 28.01.1993 “Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare”.

## VENDOSA


Regjistrimin si person juridik te Shoqerise "ARK IT" Sh.p.k. te themeluar nga DENIS HOXHA, DRITAN CELA dhe ALBAN HASA, ne kryerjen e aktivitetit:

- Projektim, mbajtje, implementim, administrim dhe konsulence te sistemeve dhe te sofwareve, te bazes se dhenave, te telekomunikacionit, transmetimit te bazave te dhenave dhe interkonektivitetit ne teresi;
- Perfaqesim dhe ndermjetesim ne trasaksione tregtare dhe ne ate te sherbimit ne favor te kompanive apo firmave te tjera qe operojne ne fusha te implementimit te softeve te ndryshem ne vecanti dhe ne fusha te ndryshme ne pergjithesi;
- Montim dhe riparim pajisjesh elektronike dhe informatike;
- Projektimi dhe implementim te sistemeve elektronike dhe telekomunikacionit si dhe software-ve perkatese;
- Ndjekje dhe kontrol i realizimit te projekteve;
- Konsulence teknike, ekonomike e juridike per specifikime teknike te rjetave dhe sistemeve te shkembimit te informacionit, ruajtjes se tij si dhe per gara dhe kontraktme;
- Importim dhe instalim sistemesh dhe paisjesh elektronike dhe te komunikimit.

Kjo Shoqeri eshte me seli ne Tirane, Rr. "Ali Pashe Gucia" Nr. 33, me nje aktivitet me afat te papercaktuar dhe me Administrator Z. DENIS HOXHA.

Kundra ketij vendimi lejohet ankim.

GJYQTAR



**URDHER - REGJISTRIMI**

1 28.073

2 (a) Emertimi: "Ade ety Pa 04"

(b) Selia: "Ade. Poni Gucia" N 33

(c) Objekti: Inojelton mbledhje, kompletim e  
dallimvlerave e korrupsione etj

(ç) Kapitali: 100.000 lll.

3. Administrator i shoqerise Ade Hoxha

Ortaket Ade Hoxha, Miler Cele

4. Statuti eshte nenshkruar me dt. 12/7/02

5. Regjistruar me dt. 19/7/2002

Mandat Arketimi Ade Hoxha

N 954 (M) 2002  
N 22966 llopri

Gjyqtare

A. Xhaxhi



**AKT THEMELIMI**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“ARK IT” SH.P.K.**

Ne Tirane, sot me daten 20 (njetete) te muajit Korrik te vitit dymije e dy, perpara meje Noterit Enketo Kelic, i Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht te quajturit Denis HOXHA, lindur me 06.04.1978 ne Shkoder, Dritan CELA, lindur me 12.02.1974 ne Durres, dhe Alban HASA, lindur me 14.05.1978 ne Puke, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nepermjet pasaportave te tyre me numrat, per Denis HOXHA Nr. 0546342, per Dritan CELA Nr. 0967606, dhe Alban HASA Nr. 2007020, te cilet shprehen deshiren dhe vullnetin e tyre te lire per te themeluar nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar me kushtet si me poshte vijon:

Ne mbeshtetje dhe zbatim te dispozitave te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare” dhe Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar “**ARK IT**” SH.P.K. (me poshte ne kete akt e quajtur “Shoqeria”), nga Ortaket Denis HOXHA, Dritan CELA dhe Alban HASA.

Kapitali themeltar i saj do te jete 100.000 (njqindmije) leke i ndare ne 100 (njqind) pjese te barabarta nga 1.000 (njemije) leke secila, i formuar nga Ortaket ne menyre proporcionale dhe te barabarte.

Objekt i veprimtarise do te jete:

- Projektim, mbajtje, implementim, administrim dhe konsulence te sistemeve dhe te softwareve, te bazes se dhenave, te telekomunikacionit, transmetimit te bazave te te dhenave dhe interkonektivitetit ne teresi;
- Perfaqesim dhe ndermjetesim ne trasaksione tregtare dhe ne ate te sherbimit ne favor te kompanive apo firmave te tjera qe operojne ne fusha te implementimit te softveve te ndryshem ne vecanti dhe ne fusha te ndryshme ne pergjithesi;
- Montim dhe riparim pajisjesh elektronike dhe informatike;
- Projektimi dhe implementim te sistemeve elektronike dhe telekomunikacionit si dhe software-ve perkatese;
- Ndjekje dhe kontrol i realizimit te projekteve;
- Konsulence teknike, ekonomike e juridike per specifikime teknike te rretave dhe sistemeve te shkembimit te informacionit, ruajtjes se tij si dhe per gara dhe kontraktme;
- Importim dhe instalim sistemesh dhe paisjesh elektronike dhe te komunikimit.

Kohezigjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete per nje periudhe kohe te pacaktuar.

Selia administrative e shoqerise do te jete ne Tirane, Rr. "Ali Pashe Gucia" Nr. 33.

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator detyren e te cilit do ta kryeje Denis Hoxha, lindur me 06.04.1978 ne Shkoder, banues ne Shkoder, dhe do te kete te drejta detyra dhe kompetenca sipas percaktimit te bere ne statutin e kesaj shoqerie dhe ne dispozitat ligjore ne fuqi.

Ngarkohet Administratori per procedurat e regjistrimit te shoqerise ne Gjykate.

THEMELUES

DENIS HOXHA



Denis Hoxha

THEMELUES

DRITAN CELA



Dritan Cela.

THEMELUES

ALBAN HASA



Alban Hasa

# STATUT

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### “ARK IT” SH.P.K.

Ortakët e shoqërisë “ARK IT” SH.P.K. janë:

Denis HOXHA, lindur me 06.04.1978 në Shkodër, dhe banor në Shkodër, Dritan CELA, lindur me 12.02.1974 në Durrës, dhe banor në Tiranë, dhe Alban HASA, lindur me 14.05.1978 në Pukë, dhe banor në Tiranë, që këtu me pas do të quhen “Ortakët” dhe që deklarohen se miratojnë këtë statut me dispozitat e mëposhtme:

### **KAPITULLI I Legjislacioni, Forma**

#### **Neni 1**

Shoqëria “ARK IT” SH.P.K., që në vazhdim shkurtimisht do të quhet “shoqëria” është krijuar në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare” dhe të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 2**

Forma juridike e shoqërisë është ajo e “shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar” prandaj përgjegjësia e ortakëve është e kufizuar deri në shumën e kapitalit themelues, në proporcion me pjesët që zotërohen prej saj.

Shoqëria, pavarësisht nga objekti i veprimtarisë, quhet tregtare dhe i nënshtrohet rregullave të përcaktuara në Kodin Tregtar të Republikës së Shqipërisë.

### **KAPITULLI II Emertimi, Selia, Kohezgjatja**

#### **Neni 3**

Emertimi i shoqërisë është:

**“ARK IT” SH.P.K.**

#### **Neni 4**

Selia e shoqërisë është në Tiranë, Rr. “Ali Pashe Gucia” Nr.33.



## Neni 5

Kohezgjatja e aktivitetit të shoqërisë është për një periudhë kohe të pacaktuar duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin e shoqërive tregtare.

## KAPITULLI III Objekti

### Neni 6

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Projektim, mbajtje, implementim, administrim dhe konsulence të sistemeve dhe të softwareve, të bazës së dhënave, të telekomunikacionit, transmetimit të bazave të të dhënave dhe interkonektivitetit në teresi;
- Perfaqësim dhe ndërmjetësim në transaksione tregtare dhe në ato të shërbimit në favor të kompanive apo firmave të tjera që operojnë në fusha të implementimit të softereve të ndryshme në vecanti dhe në fusha të ndryshme në përgjithësi;
- Montim dhe riparim pajisjesh elektronike dhe informatike;
- Projektimi dhe implementim të sistemeve elektronike dhe telekomunikacionit si dhe software-ve përkatëse;
- Ndjekje dhe kontroll i realizimit të projekteve;
- Konsulence teknike, ekonomike e juridike për specifikime teknike të rrjetave dhe sistemeve të shkëmbimit të informacionit, ruajtjes së tij si dhe për gara dhe kontraktime;
- Importim dhe instalim sistemesh dhe pajisjesh elektronike dhe të komunikimit.

## KAPITULLI IV Kapitali Themeltar

### Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë është përcaktuar në shumën 100.000 (njëqindmijë) leke.

Kapitali themeltar është i ndarë në 100 (njëqind) pjesë me një vlerë nominale të barabartë me 1.000 (njemijë) leke secila, të cilat zotërohen në mënyrë proporcionale dhe të barabartë nga Ortaket.

### Neni 8

#### Zmadhimi i kapitalit

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund të bëhet me vendim unanim të Ortakeve. Zmadhimi I kapitalit themeltar mund të bëhet me derdhje në para ose me kontribute

ne natyre, ne kete rast keto kontribute duhet te shoqerohen me nje raport vleresimi teknik te kryer nga nje ekspert I vleresimit te kontributeve, te emeruar nga Ortaket dhe qe duhet ti bashkelidhet vendimit te Ortakeve.

#### **Neni 9**

#### **Zvogelimi i kapitalit**

Zvogelimi i kapitalit themeltar mund te behet me vendim unanim te Ortakeve, me propozim te administratorit, vetem ne rastin kur shoqeria mund te pesoje humbje te tilla qe e bejne te domosdoshem kete zvogelim.

Kapitali themeltar nuk mund te jete me i vogel se vlera minimale e caktuar me ligj, ne rast te kundert shoqeria detyrohet te ndryshoje formen juridike ose te priset.

#### **Neni 10**

#### **Transferimi i pjeseve te kapitalit**

Transferimi teresisht ose pjeserisht i pjeseve te kapitalit themeltar behet gjithmone me akt noterial. Ato jane lirisht te transferueshme midis ortakeve, ne rruge trashegimie ashtu edhe tek personat e tjere qe Ortaket do ta realizojne konform ligjit "Per shoqerite tregtare".

#### **Neni 11**

#### **Ortaket e shoqerise**

Ortaket e shoqerise luajne rolin dhe kane kompetencat qe ligji "Per shoqerite tregtare" ia njuh Asamblese se ortakeve ne shoqerite e kesaj forme te themeluara nga disa ortake.

Vendimet e ortakeve shenohen ne nje regjister qe mbahet ne seline e shoqerise.

Ortaket brenda tre muajve nga dita e mbylljes se vitit financiar miratojne raportin e administrimit, iventaret dhe llogarite vjetore, nese eshte e nevojshme pas raportit te eksperteve kontabel te autorizuar, te hartuara dhe paraqitura nga administratori.

### **KAPITULLI V Administrimi i shoqerise**

#### **Neni 12**

#### **Emerimi i administratorit**

Shoqeria mund te administrohet nga nje ose me shume persona fizike qe mund te zgjidhen brenda ose jashte shoqerise.

Emerimi i administratorit behet nga Ortaket. Administratori i shoqerise do te jete Z. Denis HOXHA.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ose





statuti ia jep shprehimisht Ortakeve dhe per ceshtje te rendesishme konsultohet apo merr miratim sipas rastit nga Asambleja e Ortakeve.

Veprimtaria e perditshme e shoqerise drejtohet nga administratori, i cili per realizimin e qellimeve te shoqerise ka te drejte t'a perfaqesoje ate dhe ne emer te saj te paraqitet para te gjitha organeve e institucioneve shtetore apo private, te lidhe kontrata si dhe te paraqitet perpara gjykatave te te gjitha shkalleve per mbrojtjen e interesave te shoqerise.

Gjithashtu ka te drejte qe me prokure te posacme te autorizojte dhe jape tagrat e nevojshme personave te ndryshem te specializuar ne fusha te ndryshme, gjithmone per mbrojtjen e interesave te shoqerise.

### **Neni 13**

Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit ose per faje te kryera dhe deme te shkaktuara gjate administrimit te tij.

### **Neni 14**

Administratori shkarkohet me vendim te motivuar te Asamblese se Ortakeve, ose me vendim te gjykates me kerkese te njerit prej Ortakeve per shkelje te ligjit. Ne rast se shkarkimi i bere nga Ortaket eshte pa arsye te drejte, ai le shteg per demshperblim financiar.

## **KAPITULLI VI Te ndryshme**

### **Neni 15**

#### **Miratimi i llogarive**

Administratori brenda tre muajve nga dita e mbylljes se vitit financiar harton dhe i paraqet Asamblese se Ortakeve per miratim, raportin e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore.


Secili prej ortakeve ka te drejte te marre ne cdo kohe dhe kontrolloje dokumentat e mesiperme, per tre vitet e fundit financiare, si dhe mund te ndihmohet nga nje ekspert i zgjedhur prej tij, i cili i nenshtrohet detyrimit per te ruajtur sekretin profesional.

### **Neni 16**

Veprimtaria dhe viti fiskal i shoqerise mbyllet ne 31 Dhjetor te cdo viti.

### **Neni 17**

Nga fitimi i realizuar gjate vitit financiar, pasi te jene zbritur te gjitha shpenzimet dhe po te jete nevoja edhe humbjet e vitit te meparshem, lihet menjane nje shume me vlere jo me pak se 5% e fitimit, e cila nevojitet per formimin e fondit rezerve qe quhet



“rezerva e domosdoshme”, derisa kjo rezerve te arrije te pakten sa 1/10 e kapitalit themeltar.

Pjesa tjeter e fitimit perdoret sipas vendimit te Ortakeve.

### Neni 18

Ortakët në çdo kohë mund të vendosin prishjen e shoqërisë, në vartësi të gjendjes ekonomiko-financiare apo edhe shkaqeve të tjera që atyre mund t'u duken të arsyeshme, prishje e cila detyrimisht sjell një likuidim që do të bëhet sipas procedurave ligjore për likuidimin.


### Neni 19

Për çfarë nuk është parashikuar në këtë statut referimi do të bëhet në dispozitat ligjore që rregullojnë këto marrëdhënie juridike.

Për konfliktet të cilat nuk mund të zgjidhen me mirekuptim, palet kanë të drejtë të drejtohen në gjykatën kompetente.

ORTAKU


**DENIS HOXHA**



Denis Hoxha

ORTAKU


**DRITAN CELA**



Dritan Cela.

ORTAKU

**ALBAN HASA**



Alban Hasa


**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E NOTERISË TIRANË**

Nr. Rep 4671

Nr. Kol. 575

**V Ë R T E T I M**

Sot në datën 17.07.2002(dymije edy), në Zyrën e Noterisë në Tiranë une Notere Eriketa Kokoli ,notere ne Tirane, me Seli ne Rrugen "Kont Uran"Nr.20,vertetova firmen e Denis Hoxha ,i biri i Fiqiretit, lindur ne 06.04.1978, banues ne Shkoder me numer patente 578015 date 14.12.1999,Dritan Cela, i biri i Nebiut, lindur ne Durres me 12.02.1974, banues ne Vlore, me numer patente 522278 date 26.03.1999, si dhe Alban Hasa, i biri i Bahriut, lindur ne 14.05.1978, banues ne Tirane, pasaporte me numer 2007020 madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e cila deklaroi se se këtë kontratë e statut pasi e lexoi me zë të larte, e pasi e gjetën në përputhje me vullnetin e tyre e nënshkruan rregullisht me vullnetin e tyre të lirë, çka e vërtetoj unë si Notere me nënshkrimin tim.



# KERKESE


3 A Xhorxhi  
18 07 1993  
*[Signature]*

KERKUESI: Shoqeria "ARK IT" Sh.p.k., e perfaqesuar nga Administratori Z. Denis Hoxha,

28073

OBJEKTI: Regjistrimi si person juridik, ne Regjistrin Tregetar i shoqerise "ARK IT" Sh.p.k., ne mbeshtetje te dispozitive te ligjit 7667, date 28.01.1993.

PERPARA: GJYKATES SE SHKALLES SE PARE



TIRANE

Z. Kryetar,

Denis Hoxha, lindur me 06.04.1978 ne Shkoder, dhe banues ne Shkoder, Rr. "Hoxha Sokoli", P.1254.

Dritan Cela, lindur me 12.02.1974 ne Durres, dhe banues ne Tirane, Rr. "Ali Pashe Gucia".

Alban Hasa, lindur me 14.05.1978 ne Puke, dhe banues ne Tirane, Rr. "Irfan Tomini", Lagja 8, P.48, Shk.1, Ap.5.

Me cilesine e ortakeve kemi themeluar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "ARK IT" Sh.p.k., per te cilen kemi hartuar dhe nenshkruar edhe aktin e themelimit dhe statutin perkates.

Kapitali themeltar i kesaj shoqerie eshte 100.000 (njqindmije) leke.

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane, Rr. "Ali Pashe Gucia", Nr. 33.


Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete per nje periudhe kohe te pacaktuar.

Objekti i veprimtarise do te jete:

- Projektim, mbajtje, implementim, administrim dhe konsulence te sistemeve dhe te softwareve, te bazes se dhenave, te telekomunikacionit, transmetimit te bazave te te dhenave dhe interkonektivitetit ne teresi;
- Perfaqesim dhe ndermjetesim ne trasaksione tregetare dhe ne ate te sherbimit ne favor te kompanive apo firmave te tjera qe operojne ne fusha te implementimit te softeve te ndryshem ne vecanti dhe ne fusha te ndryshme ne pergjithesi;

*Te [Signature]*  
19/7/02  
*[Signature]*  
*[Signature]*



- 
- Montim dhe riparim pajisjesh elektronike dhe informatike;
  - Projektimi dhe implementim te sistemeve elektronike dhe telekomunikacionit si dhe software-ve perkatese;
  - Ndjekje dhe kontroll i realizimit te projekteve;
  - Konsulence teknike, ekonomike e juridike per specifikime teknike te rrjetave dhe sistemeve te shkembimit te informacionit, ruajtjes se tij si dhe per gara dhe kontraktme;
  - Importim dhe instalim sistemesh dhe paisjesh elektronike dhe te komunikimit.

Administrator i shoqerise eshte emeruar Z. Denis Hoxha, lindur ne 06.04.1978, ne Shkoder, dhe banues ne Shkoder, Rr. "Hodo Sokoli", P.1254.

Me ane te kesaj kerkese ne te njejten kohe deklarojme se mbajtesi i nje kopje originale te kesaj kerkese dhe dokumentave te tjera te themelimit te shoqerise, ka fuqi te plote qe ne emer e per llogarine tone te kryeje te gjitha procedurat e nevojshme te regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar.


Duke shpresuar se kerkesa e mesiperme, akti i themelimit dhe statuti bashkelidhur jane te drejta dhe te mbeshtetura ne ligj, lutemi beni regjistrimin si person juridik ne Regjistrin Tregtar te shoqerise "ARK IT" Sh.p.k.

Tirane me date 17.04 2002

ADMINISTRATOR

DENIS HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPERISE


NOTERIA

Nr. *Luro* Rep.



### VERTETIM NENSHKRIMI

Sot ne daten 17.07.2002,une notere Eriketa Kokoli, notere ne Tirane,Rruga”Kont Uran”Nr. 20, vertetova firmen e Denis Hoxha, I biri I Fiqiretit, lindur ne Shkoder me 06.04.1978, banues ne Shkoder,te vene ne kete Kerkese .Une noteri pasi e gjeta konform ligjes e vertetova si me poshte.



NOTER  
NOTERE  
ERIKETA KOKOLI